QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT Nr. 6419 Prot. Datë 03. 3. 2022

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË**
**PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT EUGLENT OSMANAJ**

DHKPGJP
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

**Tiranë, më 03.03.2022**

**Nr. 640/4 Dosje**

**URDHËR**

(PËR VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

**Drejtuar :** QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT-TIRANE.

**Per dijeni:**

**-Debitorit:** Shoqëria "COLOMBO" sh.p.k
**Adresa:** Lagjja Kryengritja e Fierit, rruga Vangjel Rrushku, godina nr.67, Fier.

**-Kreditorit-** Shoqeria "Alba Ceramica N" sh.p.k
**Adresa:** Autostrada Tirane-Durres, prane QTU, Ndertesa me Nr Pasurie 10/28, Zona Kadastrale 2679, Volumi 30, Faqe 237 , Mezez-Kashar, Tiranë.

---

Unë, Euglent OSMANAJ , me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat , në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 1709 të lëshuar më datë 20.12.2021 prej Gjykatës së Rrethit Gjyqesor, Fier kam vënë në ekzekutim këtë *Urdhër*, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 640, Datë 11.02.2022 kërkesën e kreditorit ***Shoqeria "Alba Ceramika N" sh.p.k*** ndaj debitorit ***Shoqeria "Colombo"sh.p.k*** , në lidhje me titullin ekzekutiv "Vendimin Nr.4376, Datë 18.05.2017 te Gjykatës së Rrethit Gjyqesor, Tirane.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin Nr.640 Dosje, Datë 15.02.2022, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhri i Ekzekutimit Nr. 1709, datë 20.12.2021 në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile,

**KONSTATOVA Se :**

**Adresa:**Blv:Gjergj Fishta, Nd.3, Hyrja 6, Ap.8 , Njesia 10 , Tirane
**Email**:euglentosmanaj@yahoo.com
**Cel**:069 74 90 508

*Shoqeria "Colombo"sh.p.k* ka marrë njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe eshte përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi per te shlyer detyrimin.

Në këto kushte në referim të nenit 527 të K.Pr.Civile duhet të filloj ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi kreditë e debitorit Shoqeria "Colombo"sh.p.k me Nipt J82916489E me Perf. Ligjor Znj. Diana Laba , në masën që do të jetë e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

**URDHËROJ**

1. **Sekuestrimin e aktiveve mbi personin juridik Shoqeria "Colombo"sh.p.k me Nipt J82916489E me Perf. Ligjor Znj. Diana Laba, me qellim mos ndryshimin apo tjetersimin e ketij personi juridik te regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit deri ne nje urdher te dyte te permbaruesit gjyqesor.**

2. Për informimin, bllokimin dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorin e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.

3. Personat që bëhen pengesë, apo të cilët i paraprijnë ndonjë ndryshimi të mundshëm në emër të debitorëve të përmendur në pikën 1, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas dispozitave sanksionuese që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me pengimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore apo të titujve ekzekutive.

4. Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

---

**PËRMBARUES GJYQËSOR**

**Euglent OSMANAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË EUGLENT P.OSMANAJ PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT

**Adresa:**Blv:Gjergj Fishta, Nd.3, Hyrja 6, Ap.8 , Njesia 10 , Tirane
**Email:**euglentosmanaj@yahoo.com
**Cel:**069 74 90 508